



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr 289/22

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje prej znj. Nita Bejta- Kryetare, znj. Kimete Gashi- Anëtare si dhe znj. Vjosa Gradinaj Mexhuani- Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: “Fidani-L (Lulzim Beqiraj B.I) & Fidani Beton”– Deçan, me nr. 289/22 kundër njoftimit mbi vendimin e AK-së, lidhur me aktivitetin e prokurimit: Ndërtimi dhe sanimi i parqeve, me nr. të prokurimit: 632-22-4421-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Komuna e Gjakovës (KK Gjakovë), më datën: 19.09. 2022, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “Fidani-L (Lulzim Beqiraj B.I) & Fidani Beton”– Deçan, me nr. 289/22 kundër njoftimit mbi vendimin e AK-së, lidhur me aktivitetin e prokurimit: Ndërtimi dhe sanimi i parqeve, me nr. të prokurimit: 632-22-4421-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Komuna e Gjakovës (KK Gjakovë).

II. ANULOHET, vendimi i AK- Komuna e Gjakovës (KK Gjakovë) lidhur me aktivitetin e prokurimit: Ndërtimi dhe sanimi i parqeve, me nr. të prokurimit: 632-22-4421-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Komuna e Gjakovës (KK Gjakovë), dhe lënda kthehet në Rivlerësim.

III. OBLIGOHET Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “Fidani-L (Lulzim Beqiraj B.I) & Fidani Beton”– Deçan aprovet si e bazuara, i bëhet kthimi i tarifës së ankesave në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës .

VI. OBLIGOHET operatori ekonomik “Fidani-L (Lulzim Beqiraj B.I) & Fidani Beton”– Deçan që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të

bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Me datën: 21.07.2022, OE “Fidani-L (Lulzim Beqiraj B.I) & Fidani Beton”– Deçan, ka parashtruar ankesë me nr. 289/22 kundër vendimit të AK, , lidhur me aktivitetin e prokurimit: Ndërtimi dhe sanimi i parqeve, me nr. të prokurimit: 632-22-4421-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Komuna e Gjakovës (KK Gjakovë).

OE ankues në ankesë pretendon se AK, nuk i ka respektuar dispozitat e nenit 61 të LPP-së.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: Punë, vlera e parashikuar e kontratës: 250.000,00 €.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 26.07.2022, ka autorizuar ekspertin shqyrtues profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palëve ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 08.08.2022, në raportin e ekspertizës ka sqaruar se:

Pretendimi nr.1 - Pretendimet kryesore ankimore sipas ankesës 289/22 kanë të bëjnë me cmimet e ofruara nga OE i rekomanduar për kontratë. OE ankues pretendon se për rreth 10 pozicione OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar cmime jo normalisht të ulëta të cilat nuk përkojnë me cmimet reale të tregut. Pas analizimit të pretendimeve ankimore, analizimit të ofertës së OE të rekomanduar për kontratë, sqarimeve të dhëna nga OE i rekomanduar për kontratë, kemi gjetur se janë tri pozicione në ofertë të OE të rekomanduar për kontratë të cilat nuk përkojnë me cmimet e tregut.

Konkretisht OE për pozicionin: 8 tek Punet me kubëza, 4 dhe 5 tek Punimi i rrethojës me tela.

Me gjithë se OE ka ofruar dekalratë nga Qori Beton se do të bëjë furnizimin e betonit prej 9 për metër kub, prap ky cmim i furnizimit e kalon gati dyfish cmimin me të cilin OE oferton, dhe këtë pa i llogaritur armaturën dhe punimet për realizim të këtij pozicioni. Vlenë të theksohet se megjithë deklaratën e Qori beton se do të bëjë furnizim të betonit me 9€ për metër kub, është vërtetë të spjegohet se si do mund të bëhet ky furnizim kur cmimi i tregut është për rreth 700% më i lart.

Po ashtu në këto pozicione ka edhe materiale tjera si armature, beton arme dhe ngjyrë, andaj e kemi të pamundur të spjegojmë se si do mund të kryhej një punë e tillë me cmim 10€.

Bazuar në këto vleresojm se pretendimet OE ankues janë pjesërisht të bazuara, megjithatë derisa nuk ka sasi idnikative për pozicionet e cekura nuk mund të japim përgjigje definitive nëse oferta e OE të rekomanduar për kontratë me cmim total a është tender jo normalisht i ulët ose jo.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 09.08.2022 me raportin e ekspertizës.

Autoriteti Kontraktues, nuk ka kthyer përgjigje lidhur me mendimin e ekspertit shqyrtues.

OE ankues “Fidani-L (Lulzim Beqiraj B.I) & Fidani Beton”– Deçan, me datë 10 Gusht 2022, me ane të parashtrësës ka deklaruar se pajtohen me mendimin e ekspertit.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës në tërësi, ka vlerësuar se, në mënyrë që të merret një vendim i duhur për këtë rast si dhe pretendimet ankimore të shqyrtohen në tërësi, qëndron nevoja e një ekspertize shtesë teknike e cila do të shqyrtonte pretendimet ankimore të OE ankuese lidhur me çmimet jo-normalisht të uleta, andaj PSH me datë 12.09.2022 ka autorizuar eksperti teknik për shqyrtimin e tyre, si dhe me datë 19.09.2022 PSH ka pranuar raportin e ekspertizës me të cilin eksperti teknik, z.Daut Ratkoceri ka paraqitur raportin si në vijim:

Lidhur me pretendimin e OE NTP FIDANI-L (Lulzim Beqiraj B.I) & FIDANI-BETON SHPK" se AK – KUVENDI KOMUNAL I GJAKOVES – komisioni i vlerësimit, edhe pas marrjes së informacioneve dhe shpjegimeve të kërkuara sipas kërkesës për sqarim mbi çmimet jo-normalisht të ulëta ka bërë vlerësimin e ofertave, njëherë edhe e propozon për shpërblim me kontratë OE “Berisha Com Sh.p.k & Joos Krasniqi-Bazë” SHPK benë shkelje të nenit 61 mbi çmimet jo-normalisht të ulëta. Sipas paragrafit 3 të këtij neni: Pas marrjes parasysh të informacioneve dhe shpjegimeve që janë dorëzuar nga tenderuesi sipas paragrafit I. të këtij neni, nëse autoriteti kontraktues konstaton se tenderuesi ka dorëzuar një shpjegim të mjaftueshëm të bazave të tenderit të tij, autoriteti kontraktues duhet të trajtojë tenderin e tillë në mënyrën e njëjtë siç i trajton edhe tenderët e tjerë. Tek kjo pikë ne konsiderojmë se ka shkelje për arsye se nuk janë dhënë shpjegimet e mjaftueshme të bazës së tenderit. -Profaturë ose dokument të mundësisë së furnizimit (me taksa dhe tatime) edhe këtu tek ofrimi i profaturave dhe ofertave është i mangët për arsye se disa nga ofertat e marrura nuk janë as për se afërmi me çmimet e tregut aktual, siç është oferta për furnizim me beton ku çmimi për 1 Mb 30 është 9€.

Ekspertit shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues NTP FIDANI-L (Lulzim Beqiraj B.I) & FIDANI-BETON SHPK". duke u bazuar në faktet e prezantuar në dokumentacionin që kam pranuar në shqyrtim sqaroj se: Autoriteti kontraktues respektivisht komisioni për vlerësimin e tenderëve, gjatë vlerësimit të ofertave ka konstatuar se disa operator të përgjegjshëm me ofertën e tyre kanë ofruar tender jo- normalisht të ulet, me datën 30.06.2022, ju është drejtuar operatoreve ekonomik për sqarimin me : “Letër Standarde e kërkesës për informata mbi tenderët jo-normalisht të ulet” dhe atë: “Duke dorëzuar me shkrim një deklaratë të nënshkruar dhe vulosur duke zberthyer në mënyrë të detajuar kalkulimin e çmimit të paraqitur. Si dëshmi duhet të paraqitet për secilin pozicion të me poshtëm

Kukulimin e detajuar të shpenzimeve

Profaturë ose dokument të mundësisë së furnizimit në fjale (me të gjitha taksat tatimore)

Kukulimin e fitimit

Për operatorin ekonomik të propozuar për kontrate ka kërkuar për pozicionet e me poshtëm.:

- PUNET ME KUBEZA pozicionet: 2, 8, 9;
- PUNIMI I RRETHOJES ME TELA: pozicionet: 2, 3, 4, 5, 6
- PUNET E GJELBRIMIT:3
- POZICIONET CA TE LARTA
- PUNET ME KUBEZA, pozicioni: 10”

Me datën 04.07.2022 autoriteti kontraktues – komisioni për vlerësim e pranon: “Letër Sqarimi për projektin me titull: “Ndërtimi dhe sanimi i parqeve” në të cilin i jep sqarimet e tij mbi arsyeshmërin e vendosjes së çmimeve në pozicionet të kërkuara për sqarim nga AK-ja”.

Komisioni. I vlerësimit të ofertave ka vazhduar punën, pas vlerësimit dhe krahasimit të ofertave dhe sqarimeve për tenderët jo normalisht konstaton se nga OE janë ofruar sqarimet e kërkuara dhe të mjaftueshme.

Eksperti shqyrtues sqaron se operatori ankues pretendon se sqarimet e kërkuar nga Autoriteti Kontraktues për operatorin ekonomik të propozuar për kontratë: “Berisha Com Sh.p.k & Joos Krasniqi-

Bazë SHPK”, s’janë dorëzuar ato të cilat janë kërkuar me “Letër Standarde e kërkesës për informata mbi tenderët jo-normalisht të ulet”

Sepse nuk ka dorëzuar:

1.– Kalkulimin e detajuar të shpenzimeve të grupi i operatoreve ekonomik : Berisha Com Sh.p.k & Joos krasniqi-Bazë Shpk nuk e kanë ofruar kalkulimin e detajuar të shpenzimeve siq është kërkuar nga ana e juaj por vetem e kanë ofruar deklaratë të përgjithësuar të pozicioneve dmth mungon tabelari i kalkulimeve të detajuara të shpenzimeve.

2.–Profaturë ose dokument të mundesisë së furnizimit (me taksa dhe tatime) edhe ketu tek ofrimi i profaturave dhe ofertave është i mangët për të cilën do të japim sqarime me poshtë.

3– Kalkulim i fitimit : edhe të kjo pikë nuk është ofruar asnjë kalkulim të fitimit në bazë të atyre çmimeve që kanë ofertuar operatorët ekonomik : **Berisha Com Sh.p.k & Joos krasniqi-Bazë Shpk** dmth mungon tabelari i kalkulimit të detajuar të fitimit.

Eksperti shqyrtues pas analizimit të fakteve të ofruara në dispozicion siq është letra sqaruese e OE “Berisha Com Sh.p.k & Joos Krasniqi-Bazë SHPK”, e datës 04.07.2022 sqaron se Autoriteti Kontraktues- Komisioni për vlerësim nuk e ka bërë vlerësimin e sipas LPP-se nenit 61 Tenderët Jo-Normalisht të Ulet, paragrafi 2, nën paragrafin 2.1; 2.4; paragrafi 4 sepse operatori ekonomik i propozuar për kontratë nuk i ka dhënë sqarimet e kërkuar sipas “Letër Standarde e kërkesës për informata mbi tenderët jo-normalisht të ulet” dhe atë - Kalkulimin e detajuar të shpenzimeve

Për këtë kërkesë OE ka dhënë shpjegime kryesisht me këto fjale se: “e kemi në stok”, “e transportojmë me makinerinë tone”, “nuk kemi shume kosto” të gjitha këto thënie për sqarime janë se këto pozicione do të punohen “gratis” ,

Në bazë të LPP-se Një procedurë e tillë nuk është e rregulluar me dispozita të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik dhe as me legjislacionin dytësor të nxjerrë nga KRPP në bazë të autorizimeve që i janë dhënë me këtë ligj, megjithatë autoritetet kontraktuese duhet të veprojnë si në vijim:

Nëse Operatori Ekonomik plotëson në një nga pozicionet si: “gratis”, tenderi duhet të refuzohet pasi që dhuratat nuk janë të pranueshme.

Me poshtë do ta sqaroj se si duhet të llogariten shpenzimet për një aktivitet të prokurimit duke u bazuar në Normat Ndërtimore “GN1”

II. PUNIMI I RRETHOJAVE ME TELA

	Përshkrimi	Njësia Matëse	Sasia (për njësi)	Çmimi për njësi me TVSH €	Çmimi total me TVSH
4	Furnizimi me material dhe betonimi i mureve të rrethojës me natyrë beton MB 30 me kallypet e nevojshme. Muret të punohen në tërë gjatësinë e rrethojës në lartësi min 50 cm nga niveli i terrenit dhe gjerësi 20 cm. Muret të armirohen me armaturë rrjetë RØ8 (15/15) cm, të montuara në tërë gjatësinë e rrethojës e cila duhet të lidhet me armaturën e themeleve. Në llogari hynë edhe 1.) lysterja e murit beton arme me ngjyrë sipas zgjedhjes së organit mbikëqyrës e cila duhet të jetë e rezistueshme ndaj ndikimeve të jashtme. Llogaria bëhet në m ³ të murit të punuar sipas këtij përshkrimi.	m ³	1	10	10

¹ Normat Ndërtimore të ish Jugosllavisë pasi Republika e Kosovës ende nuk i ka aprovuar.

Për punimin e murit të rrethojës me natyre beton MB 30: duhet të kryhen këto aktivitete të punës për të cilat duhet të llogaritet: sasia e materialit; fuqia punëtore e angazhuar dhe çmimi:

- I. Gërmimi i dheut për formimin e themelit
 - Pozicioni i gërmimit është dhënë pozicion i veçantë këtu nuk llogaritet .
- II. Punimi i kallëpit ne dy anët me dërrasa $d=24$ mm si dhe elementet tjera dhe demolimi e pastrimi i tije
 - Fuqia punëtore e cila është e nevojshme
 - Sasia e materialit të nevojshëm
 - Çmimi i fuqisë punëtore dhe materialit
- III. Përgatitja e betonit dhe betonimi i tije
 - Fuqia punëtore e cila është e nevojshme
 - Sasia e materialit të nevojshëm
 - Çmimi i fuqisë punëtore dhe materialit
- IV. Punimi i armaturës
 - Fuqia punëtore e cila është e nevojshme
 - Sasia e materialit të nevojshëm
 - Çmimi i fuqisë punëtore dhe materialit
- V. Lyerja e murit me ngjyre
 - Fuqia punëtore e cila është e nevojshme
 - Sasia e materialit të nevojshëm
 - Çmimi i fuqisë punëtore dhe materialit

Fillojmë me llogaritjen:

Punimi i kallëpit ne dy anët me dërrasa $d=24$ mm si dhe elementet tjera dhe demolimi e pastrimi i tije. Norma për kallëp me dërrasa $d=24$ mm ne të dy anët është NN (GN) 601-201, 160402 - 2.1

Punimi i kallëpit 100 m^2 - [për me qen ma të qartë në llogari kemi përvetësuar që punimi i kallëpit për betonim të behet për 100 m^2 ($2 \times 0.5 \times 100$) = 100 m^2 puna të kryhet për 3 ditë] pasi që në përshkrim të çmimit sasia për njësi është dhënë =1

Nevojitet:

Punimi i kallëpit ne dy anësor me dërrasa $d=24$ mm ... N2 ... 1.07 $1.04 \times 100 = 104 \text{ N}$
Materiali i nevojshëm dhe fuqia punëtore

☞ Materiali i nevojshëm

Për realizimin e këtij aktiviteti do të përdoret ky material:

☞ Llogaritja e numrit të punëtorëve sipas formulës $(N_p) = \Sigma N / (d \times h)$ koha e kryerjes për dy ditë pune

- L V = $(38.00) / (3 \times 8) = 1.58$ përvetësojmë 2 punëtorë
- L III = $(56.00) / (3 \times 8) = 2.33$ përvetësojmë 2 punëtorë
- P II = $(24.00) / (3 \times 8) = 1.00$ përvetësojmë 1 punëtorë

II. Përgatitja e Betonit MB 30 sasia 10.00 m^3

Sasia e materialit për përgatitjen e betonit për themele me markë të betonit MB 30
Sasia për llogaritje është marre $(0.5 \times 0.2 \times 100) = 10.00 \text{ m}^3$ për llogaritje me të kuptueshme, pasi që në përshkrim të çmimit sasia është dhënë =1 m^3

Materiali i nevojshëm dhe fuqia punëtore

☞ Materiali i nevojshëm

Për realizimin e këtij aktiviteti do të përdoret ky material:

Materiali m ²	për 1.00 m ²	për 100.00
- Dërrasa d=24 mm/ m ³ 0.0333.30
- Trareza (5/) cm/ m ³ 0.0353.50
- Tel për lidhje kg 0.077.00
- Gozhda kg 0.1515.00
- Mbajtës (zhileta, pyka) kg 0.1010.00

Vërejtje : dërrasat 2.4 mm dhe trarëzat 5/8 cm do të përdoren nga 4 deri ne 6 here ne pune

☞ Punimet e kallëpit

- Punimi i kallëpit – fuqia punëtore sipas Normave Ndërtimore për 1m²
 - o Punëtor me kualifikim Latues – L V0.20 0.20 x 100.00 = 20.00
 - o Punëtor me kualifikim Latues - L III0.20 0.20 x 100.00 = 20.00
- Vendosja e kallëpit – montimi
 - o Punëtor me kualifikim Latues – L V0.18 0.18 x 100.00 = 18.00
 - o Punëtor me kualifikim Latues - L III0.18 0.18 x 100.00 = 18.00
- Demolimi i kallëpit
 - o Punëtor me kualifikim Latues – L III0.18 0.18 x 100.00 = 18.00
 - o Punëtor pa kualifikim - P II0.11 0.11 x 100.00 = 11.00
- Pastrimi i kallëpit
 - o Punëtor pa kualifikim – P II0.13 0.13 x 100.00 = 13.00

☞ Fuqia punëtore e nevojshme

- Punëtor me kualifikim Latues - L V (0,20+ 0,18) = 0.380.38 x 100 = 38.00
- Punëtor me kualifikim Latues - L III (0,2 +0,18+0,18) = 0.560.56 x 100 = 56.00
- Punëtor pa kualifikim - P II (0,11 + 0,13) = 0.240.24 x 100 = 24.00

☞ Llogaritja e numrit të punëtorëve sipas formulës $(N_p) = \Sigma N / (d \times h)$ koha e kryerjes për dy ditë pune

- L V = (38.00) / (3 x 8) = 1.58 përvetësojmë 2 punëtorë
- L III = (56.00) / (3 x 8) = 2.33 përvetësojmë 2 punëtorë
- P II = (24.00) / (3 x 8) = 1.00 përvetësojmë 1 punëtorë

III. Përgatitja e Betonit MB 30 sasia 10.00 m³

Sasia e materialit për përgatitjen e betonit për themele me markë të betonit MB 30
 Sasia për llogaritje është marre (0.5 x 0.2 x 100) = 10.00 m³ për llogaritje me të kuptueshme, pasi që në përshkrim të çmimit sasia është dhënë =1 m³

Materiali i nevojshëm dhe fuqia punëtore

☞ Materiali i nevojshëm

Për realizimin e këtij aktiviteti do të përdoret ky material:

Materiali	për 1.00 m ³	për 10.00 m ³
- Çimento PC 35 / kg 300,003000 kg
- Zhavor i granular për beton / m ³ 1,28012,80 m ³
- Ujë / m ³ 0.181,80 m ³

Furnizimi dhe vendosja me pompe për beton V= 10 m³- krahu me gjatësi deri në 20 m' N 1.42

☞ Fuqia punëtore

..... GN – 400-504 4.1 - 154104

Llogaritja e numrit të nevojshëm të punëtorëve	për 1.00 m ³	për 10.00 m ³
Betonues V -1.00	1.00 x 10.00 = 10.00
Betonues III -1.00	1.00 x 10.00 = 10.00
Punëtorë II -2.35	2.35 x 10.00 = 23.50

Llogaritja e numrit të punëtorëve sipas formulës (Np) = Σ N x Np / (d x h) koha e kryerjes për 1 ditë pune

- Betonues V = (10.00) / (1 x 8) = 1.25 përvetësojmë 1 punëtorë
- Betonues III = (10.00) / (1 x 8) = 1.25 përvetësojmë 1 punëtorë
- Punëtorë II = (23.50) / (1 x 8) = 2.94 përvetësojmë 3 punëtorë

IV. Sasia e materialit për përgatitjen e armaturës për muret e rrethojës me armature rrjete RØ 8 (15/15)

Sasia për llogaritje është marre (0.5 x 100) 1.16 = 58.00 m² për llogaritje me të kuptueshme, pasi që në përshkrim të çmimit sasia është dhënë =1 m³

Materiali i nevojshëm dhe fuqia punëtore 4.5 cope rrjete (2.2 x 6.0)m

☞ Materiali i nevojshëm

Materiali	për 1.00 m ³	për 10.00 m ³
—Armaturë rrjetë RØ 8 (15/15) / kg 32.4 kg 324 kg

☞ Fuqia punëtore

Llogaritja e numrit të nevojshëm të punëtorëve	për 1.0 kg	për 324.0 kg
Armirus A VII - 1.000.002	0.002 x 324.0 = 0.648

Armirues A III - 2.000.020	0.020 x 324.0 = 6.480
Punëtorë P II - 2.350.0001	0.0001 x 324.0 = 0.032

Llogaritja e numrit të punëtorëve sipas formulës $(N_p) = \Sigma N / (d \times h)$ koha e kryerjes për 1 ditë pune

- Armirues A VII = $(0.648) / (1 \times 8) = 0.08$ përvetësojmë 1 punëtorë
- Armirues A III = $(6.480) / (1 \times 8) = 0.81$ përvetësojmë 1 punëtorë
- Punëtorë P II = $(0.032) / (1 \times 8) = 0.004$ përvetësojmë 1 punëtorë

Brigada punuese për armimin e murit do të jetë :

- 1 Punëtor armirues A VII
- 1 Punëtor armirues A III
- 1 Punëtor pa kualifikim P II

V. Sasia e materialit për ngjyrosjen të murit

..... GN – 531-5303 330905- 5

Sasia për llogaritje është marr pjesa horizontale + sipërfaqja e murit në të dy anët $(0.2 \times 100) + (0.5 \times 100) \times 2 = 20.0 + 100.0 = 120.0 \text{ m}^2$, për llogaritje me të kuptueshme, pasi që në përshkrim të çmimit sasia është dhënë $= 1.0 \text{ m}^3$

Materiali i nevojshëm

- ngjyrë $0.10 \text{ kg} / \text{m}^2 \times 120.0 \text{ m}^2 = 12.0 \text{ kg}$
- Minium $0.080 \text{ Kg} / \text{m}^2 \times 120.0 \text{ m}^2 = 9.6 \text{ kg}$

Fuqia punëtore

Llogaritja e numrit të nevojshëm të punëtorëve	për <u>1.0 m²</u>	për <u>120.0 m²</u>
Punëtor i pa kualifikuar PII - 0.230.23	0.23 x 120.0 = 27.6

Llogaritja e numrit të punëtorëve sipas formulës $(N_p) = \Sigma N / (d \times h)$ koha e kryerjes për 1 ditë pune
Punëtor i pa kualifikuar PII = $(27.6) / (1 \times 8) = 3.45$ përvetësojmë 3 punëtorë

Rekapitullim i materialit për përshkrimin: II. PUNIMI I RRETHOJAVE ME TELA pozicionin - 4			
Nr	Aktiviteti	njësia	sasia
1	Dërrasa d= 24 mm / përdoren 6 here	m3	3.30
2	Trarëza 5/8 cm/ përdoren 6 here	m3	3.5
3	Tel për lidhje të kallëpit	kg	7
4	Gozhda të ndryshme	kg	15
4	Mbajtës , elemente hekuri	kg	10
5	Çimento thasë 50 kg	cope	60

6	Zhavor I granular	m3	12.8
7	Ujë për përgatitjen e betonit	m3	1.8
8	Punëtor latues -L V	person	6
9	Punëtor latues -L III	person	6
10	Punëtor pa kualifikim -P II	person	3
11	Pompe betoni 9 m3	cope	1
12	Punëtor betonues -B V	person	1
13	Punëtor betonues - B III	person	2
14	Punëtor pa kualifikim PII	person	2
15	Armatura rrjetë Q 335 (4.5 cope rrjetë x 72 kg/ cope)	kg	324
16	Punëtor armirues A VII	person	1
17	Punëtor armirues A III	person	1
18	Punëtor pa kualifikim PII	person	1
19	Ngjyre për ngjyrosjen e murit të betonit.	Kg	12.0
20	Minium	Kg	9.6
21	Punëtor pa kualifikim PII	Person	3

Eksperti shqyrtues sqaron se të gjitha këto aktivitete të punës të dhena ne këtë rekapitullim kanë një kosto ne vlere/ euro e cila duhet të llogaritet për këtë aktivitet të pune si dhe aktivitete tjera.

Operatori ekonomik i propozuar për kontratë me letrën sqaruese nuk i ka dhënë kalkulimin e detajuar të shpenzimeve siç është kërkuar me “Letër Standarde e kërkesës për informata mbi tenderët jo-normalisht të ulet”

Siç po shihet nga ky Rekapitullim ne tabelën me lartë, vetëm sasia e armaturës për 1.0 m3 beton e cila është 32.4 kg e tejkalon për tri herë çmimin e dhënë me ofertë në përshkrimin: II. PUNIMI I RRETHOJAVE ME TELA poz.4 cili është = 10 euro /m3 beton të vendosur në punë.

Sa i përket kërkesë “Letër Standarde e kërkesës për informata mbi tenderët jo-normalisht te ulet” për dorëzim e “Profaturës ose dokument të mundësisë se furnizimit ne fjale (me të gjitha taksat tatimore)” të kërkuar me nga Operatori ekonomik i propozuar për kontratë, ka dorëzuar :

- Ofertë për furnizim me fraksione zhavor nga kompania “Geo Mineral SHPK” me NUI: 810316324 me seli në Astrazub – Malishevë
- Ofertë nga për furnizim me beton MB 30 nga “Qori Beton” SH.P.K. me NUI : 811359274 me seli ne Rogovë - Gjakovë
- Ofertë nga për punimin e gardhit metalik rrethues nga “OPTICON “ SHPK Nr. Fiskal 600751516 me seli në –Ferizaj.

Mirëpo të gjitha këto oferta të dorëzuar përmbajnë çmime ab-normalisht të ulëta duke e ditë se sa janë rritur çmimet e materialit me të cilat do të realizohen këto pozicione dhe sidomos çmimi i hekurit, cementit dhe derivateve të cilat çmime janë të përcaktuar në BERZH.

Ndërsa sa i preket kalkulimit të fitimit të kërkuara me "Letër Standarde e kërkesës për informata mbi tenderët jo-normalisht të ulët" për pozicionet e kërkuare operatori ekonomik i propozuar për kontratë nuk ka ofruar llogaritjen kalkulimin e fitimit ne as një lloj forme.

Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se pretendimet i OE ankues janë të bazuara.

MENDIMI I EKSPERTIT PROFESIONAL/ TEKNIK SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Ekspertit Shqyrtues i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa: OE "NTP FIDANI-L (Lulzim Beqiraj B.I) & FIDANI-BETON SHPK" ankues të merret e bazuar., dhe rekomandojmë që Autoriteti Kontraktues të bëjë ANULIMIN - B58 NJOFTIM PER VENDIMIN E AUTORITETI KONTRAKTUES dhe lënda të kthehet në RI- VLERËSIM.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar AK me datë: 19.09.2022 me raportin e ekspertizës.

Autoriteti Kontraktues, me ane te parashtrësës ka deklaruar se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit.

Seanca e shqyrtimit te lëndes është mbajtur me datën: 19 Shtator 2022, pa pranin e palëve konform nenit 24.1 te Rregullores se OSHP-se, ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, kërkesa për rishqyrtim, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit, raporti i ekspertit teknik shqyrtues dhe të gjithë parashtrësat e palëve në procedurë. Marrë këtë parasysh, PSH mbështetet ne raportin e ekspserizes se pare te ekspertit shqyrtues si dhe ne raportin e ekspertit teknik shqyrtues se ankesa e OE ankuese lidhur me çmimet jo-normalisht te ulëta aprovohet dhe kthehet lenda ne ri-vlerësim.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit teknik deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron:

Lidhur me pretendimin e ankimore të OE ankues se OE e rekomanduar ka ofertuar çmime jo-normalisht te ulëta per 10 pozicione te cilat nuk përkojnë me çmimin real te tregut. Pas analizimit te raportit te ekspertit shqyrtues i cili konstaton se "*për te paktën 3 pozicione OE e rekomanduar ka çmime qe janë ne mase te madhe me te ulëta se çmimet reale te tregut*" si dhe raportin e ekspertit teknik i cili fillimisht sqaron se AK i është drejtuar operatoreve ekonomik me "Letër standarde e kërkesës për informata mbi tenderët jo-normalisht te ulët" duke specifikuar se te njëjtit duhet te ofrojnë dëshmi për: kalkulimin e detajuar te shpenzimeve, profature ose dokument te mundësisë se furnizimit ne fjale (me te gjitha taksat tatimore) dhe kalkulimin e fitimit, dhe ka konstatuar se OE e rekomanduar lidhur me kalkulimin e detajuar te shpenzimeve nuk ka ofruar kalkulimin e detajuar te shpenzimeve siç është kërkuar nga AK, për me tepër eksperti ka bërë përllogaritjet si me lart me te cilën konstatohet se "*vetëm sasia e armaturës për 1.0 m³ beton e cila është 32.4 kg e tejkalon për tri herë çmimin e dhënë me ofertë në përshkrimin: II. PUNIMI I RRETHOJAVE ME TELA poz.4*" si dhe sa i përket dëshmisë se dYTE profature ose dokument te mundësisë se furnizimit ne fjale (me te gjitha taksat tatimore) te kërkuar nga AK i njëjti ka ofruar oferta te cilat konstatohen se kane çmime ab-normalisht te ulëta dhe nuk ka ofruar fare kalkulimin e fitimit ne asnjë lloj forme, PSH konstaton se pretendimi i OE ankuese është i bazuar ashtu qe AK nuk ka respektuar nenin 61 te LPP-se dhe ka shpallur fitues një OE te papërgjegjshme. Kështu që, edhe

arsyetimet e dhëna nga eksperti shqyrtues llogariten si arsyetime të panelit shqyrtues dhe lënda i kthehet AK-se për rivlerësim.

Vendimi lidhur me kthimin e tarifës u dha ne kuptim te nenit 31 paragrafi 6 i Rregullores se punës se OSHP-se.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi

Kryetare e Panelit Shqyrtues

znj.Nita Bejta



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK– Komuna Gjakove
- 1x1 “Fidani-L (Lulzim Beqiraj B.I) & Fidani Beton”– Deçan
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.